

LAJME TË MIRA NGA

SUNDIMI I LIGJIT

RAPORT TREMUJOR 1

REFORMAT E AVANCUARA
TË GJYQËSORIT

TRAJNIM PËR KOMUNIKIM

PLANI NACIONAL I VEPRIMIT PËR
TË DREJTAT E FËMIJËVE NË
MAQËDONINË E VERIUT

BESIMI ËSHTË ÇELËSI

EU SUPPORT FOR
LAW FORUM

NISJA E
PROJEKTIT

RUAJ DATËN!

KUSH JEMI NE?



Funded by
the European Union





KLAUZOLË PËRJASHTIMI:

KY RAPORT ËSHTË FINANCUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN. PËRMBAJTJA E TIJ ËSHTË PËRGJEGJËSI E VETME E LUDWIG BOLTZMANN GESELLSCHAFT - INSTITUTI I TË DREJTAVE THEMELORE DHE TË NJERIUT (LBI-GMR) DHE NUK PASQYRON DOMOSDOSHMËRISHT PIKËPAMJET E BASHKIMIT EVROPIAN.



**Financuar nga
Bashkimi Evropian**



PARATHËNIE



Dieter SCHINDLAUER

Drejtues ekipi, "Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit"

"Ne shfrytëzojmë këtë botim për të ruajtur një frymë të mirë dhe për të mbështetur një etikë besimi në arsyen e mirë për ndryshim, reformë dhe një proces të vazhdueshëm përmirësimi. Për ta bërë këtë, ne do të tregojmë hapat përpara në mënyrë të tillë që ata të mos humbasin në mesin e zhurmës mbizotëruese të lajmeve zhgënjyese".

I nderuar lexues,

Para jush ndodhet edicioni i nëntorit i raporteve tremujore të projektit "Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit" -e ky punim është përplot lajme të mira.

Projekti ynë përbën një përkushtim dhe investim të madh nga Bashkimi Evropian për të ardhmen e Maqedonisë së Veriut. Sundimi i ligjit është kaq themelor për demokracinë, ekonominë dhe lirinë dhe sigurinë e qytetarëve, sa që përpjekje të tilla të mëdha janë më se të përshtatshme për të përmirësuar situatën dhe për të prodhuar rezultate të prekshme për më shumë se tre vjet. Gjithashtu, projekti ynë është i përkushtuar për të arritur sukses dhe për t'u bërë diçka për të cilën të tjerët do të flasin. Kjo është arsyeja se pse, çdo tre muaj, ne nxjerrim këtë botim plot me lajme të mira rreth sundimit të ligjit.

Mund të thuhet shumë gjëra të mjerueshme për fushën tonë të punës dhe mediat janë përplot lajme të këqija, skandale, thashetheme dhe ngjarje dekurajuese. Ne sigurojmë që projekti ynë nuk është jokritik, i verbër ose i heshtur ndaj ndonjë dukurie apo zhvillimi negativ; përkundrazi: këto na frymëzojnë të punojmë edhe më shumë dhe të jemi më të përkushtuar.



PARATHËNIE



Duhet të ketë një vend dhe kohë për të komunikuar edhe për gjërat e mira që po ndodhin, për përpjekjet, reformat, angazhimin dhe mundin që po ndodh me dhe brenda institucioneve publike, - për iniciativat dhe hapat e ndërmarra në drejtimin e duhur.

Për këtë gjë shërben raporti ynë tremujor. Kredoja e medias "lajmi i keq është lajm i mirë" nuk gjen zbatim këtu. Ne shfrytëzojmë këtë botim për të ruajtur një frymë të mirë dhe për të mbështetur një etikë besimi në arsyen e mirë për ndryshim, reformë dhe një proces të vazhdueshëm përmirësimi. Për ta bërë këtë, ne do të tregojmë hapat përpara në mënyrë të tillë që ata të mos humbasin në mesin e zhurmës mbizotëruese të lajmeve zhgënjyese.

Në këtë edicion do të gjeni histori dhe informacione mbi projektin tonë dhe fushat e ndryshme në të cilat ekipi ynë ka punuar së bashku me partnerët tanë nacionalë për një sundim të fortë dhe të besueshëm të ligjit.

Dieter Schindlauer
Drejtues ekipi



SUNDIMI I LIGJIT

- Gjyqësori duhet të jetë i pavarur dhe i paanshëm; procedurat dhe vendimet duhet të jenë të ligjshme dhe të drejta.
- Krimi duhet të zbulohet, të ndiqet penalisht dhe të dërgohet në gjyq; krimi nuk duhet të përfitojë.
- Nuk duhet të ketë tolerancë për korrupsionin dhe integriteti duhet të forcohet.
- Të drejtat themelore dhe ato të njeriut duhet të mbrohen në mënyrë efektive.



Kush jemi ne?

Projekti "Mbështetje e BE-së për Sundim të Ligjit" ka për qëllim **FORCIMIN** e sundimit të ligjit në Republikën e Maqedonisë së Veriut .

Ne mbështesim institucionet përkatëse që punojnë në fushat e drejtësisë, zbatimit të ligjit, parandalimit të korrupsionit dhe promovimit dhe mbrojtjes së kapaciteteve themelore dhe të drejtave të njeriut, efektivitetit dhe ndikimit.

Misioni ynë është të sigurojmë që gjërat të jenë të drejta për të gjithë!

EKIPI



IDENTITETI



1

QËLLIMI

Projekti është i përpiluar në mënyrë të tillë që të mbështesë institucionet përkatëse të cilat punojnë në fushat e drejtësisë, zbatimit të ligjit, parandalimit të korrupsionit dhe promovimit dhe mbrojtjes të drejtave themelore dhe të njeriut për të përmirësuar kapacitetet, efektivitetin dhe ndikimin.

2

KOMPONENTËT

C1: Gjyqësori

Përmirësimi i kapaciteteve të institucioneve të drejtësisë për të ofruar drejtësi në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme

C2: Policia

Përforcimi i kapaciteteve për t'i zbatuar në mënyrë efektive teknikat moderne të hetimit në luftën kundër krimit të organizuar

C3: Anti-korrupsioni

Përmirësimi i parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit

C4: Të drejtat themelore dhe të njeriut

Përmirësimi i mbrojtjes së të drejtave themelore

SHIFRAT E PROJEKTIT

Projekti “Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit” financohet plotësisht nga Bashkimi Evropian. Kohëzgjatja e projektit do të jetë 36 muaj me një shtesë të parashikuar prej 6 muajve të tjerë me një buxhet prej 10,25 milion euro. Ekipi i Projektit aktualisht përbëhet nga 28 anëtarë: drejtues të përbërësve, ekspertë, asistentë etj.



10,25 MILIONË EURO



36+ MUAJ



28+ ANËTARË EKIPI



PREZANTOJMË:

24

REZULTATE

Objektiva konkretë me ndikim të prekshëm dhe të matshëm në fushën e gjyqësorit, zbatimit të ligjit, parandalimit të korrupsionit dhe promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave themelore dhe të njeriut.

+54

AKTIVITETE

Koordinimi i iniciativave për rritjen e ndërgjegjësimit, forcimin e aftësive të institucioneve përfituese në Maqedoninë e Veriut, ofrimi i ndihmës për punën e tyre, lehtësimin e rrjeteve dhe grupeve bashkëpunuese të punës dhe përpjekje të ngjashme.

31

PËRFITUES

Projekti ka krijuar një bashkëpunim profesional me institucionet përfituese maqedonase për të promovuar llogaridhënien dhe për t'i inkurajuar dhe mbështetur këto institucione që ato të marrin një rol proaktiv në sferën e tyre profesionale.

+82

TAKIME

Në një periudhë prej tre muajsh, përfaqësuesit e Komponentit u angazhuan në mënyrë aktive me mbi 112 takime, duke nxitur bashkëpunimin produktiv me institucionet përfituese.

LE TË FLASIM PËR...

- "Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit" fillon me një përkushtim të palëkundur dhe fokus mbi reformën
- Besimi është çelësi: Policia sllovene ndau njohuritë e saj mbi policimin ndërkombëtar dhe mbrojtjen e dëshmitarëve
- Projekti "Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit" fuqizon mbrojtësit e të drejtave të njeriut duke i trajnuar mbi parandalimin e diskriminimit dhe promovimin e barazisë
- Maqedonia e Veriut avancoi reformat në gjyqësor përmes udhëzimeve eksperte dhe bashkëpunimit të palëve të interesuara
- Daniella Stefanovska, Këshilltare - Inspektorati Shtetëror i Punës: Rëndësia e trajnimit të vazhdueshëm, bashkëpunimit midis institucioneve dhe komunikimit të qartë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore
- Drejt një Plani Nacional Gjithëpërfshirës të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve në Maqedoninë e Veriut
- Forcimi i ndërgjegjësimit dhe komunikimit në shërbimin e probacionit
- Trajnim i Përbashkët për Komunikim për Institucionet e Pavarura

“Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit” fillon me një përkushtim të palëkundur dhe fokus mbi reformën

Udhëtimi ynë fillon me një vizion – një vizion për të fuqizuar Maqedoninë e Veriut me një përkushtim të përtërirë ndaj sundimit të ligjit. **Më 21 shtator 2023 festuam fillimin zyrtar të projektit "Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit".** E ç'projekt që është! Bashkimi Evropian tregon qartë kujdesin dhe mbështetjen e tij të guximshme për njerëzit e vendit duke financuar plotësisht këtë përpjekje me më shumë se 10 milionë euro të dedikuara për përmirësimin e sundimit të ligjit në disa nivele.

Ky projekt është më shumë se thjesht një iniciativë e re; është një moment historik në udhëtimin e Maqedonisë së Veriut drejt anëtarësimit në BE. Sundimi i ligjit dhe garancitë, kontrollet dhe balancimet përkatëse, si dhe integriteti dhe transparenca e sistemeve përkatëse janë tejet të rëndësishme në këtë fazë.



Ambasadori Dejvid Gir, kreu i Delegacionit të BE-së në Maqedoninë e Veriut, me fjalimin e tij, vulosi hapjen e projektit: "Kjo është një mundësi e madhe për të përparuar me vendosmëri në reforma dhe veçanërisht në fushën e sundimit të ligjit. Andaj unë ju bëj thirrje të gjithë juve që punoni në fushën e sundimit të ligjit të njiheni me standardet dhe praktikatat në Bashkimin Evropian dhe ta përdorni këtë gjë si një shtytje të fuqishme për të ndryshuar nga brenda. Ju bëj thirrje të gjithëve që ta shfrytëzoni tani këtë mundësi në interes të qytetarëve dhe të ardhmes evropiane të këtij vendi". Fjalët e tij kumbojnë si një parim që do të na udhëzojë në rrugën përpara.



Hapja u nderua gjithashtu nga tre ministra të dalluar: **Oliver Spasovski** (Ministri i Punëve të Brendshme të Maqedonisë së Veriut), **Krenar Lloga** (Ministri i Drejtësisë i Maqedonisë së Veriut) dhe **Jovanka Treņevska** (Ministre e Punës dhe Politikës Sociale të Maqedonisë së Veriut). Prania e tyre thekson rëndësinë e Projektit dhe përkushtimin e tyre të palëkundur që ai të ketë sukses, duke e përforcuar misionin tonë me vendosmëri.



Qasja jonë ka rrënjë të thellanë bashkëpunim dhe partneritet, siç theksohet nga **Patricia Musi Mailer**, Drejtoresha Administrative e LBI-GMR. Ajo deklaroi qartë: "Ky projekt do të jetë efektiv dhe i qëndrueshëm sepse ne vërtet, do të punojmë së bashku me partnerët tanë maqedonas: në një marrëdhënie të ngushtë, në bazë ditore, me dobishmëri për të dyja palët". Ky përkushtim për barazi dhe unitet është themel i rrugëtimit tonë.

Ekipin tonë shumështrësor e drejton Lideri i Ekipit të Projektit, **Dieter Shindlauer**, i cili në hapje të projektit prezantoi komponentët e tij kryesorë, duke treguar udhën e transformimit që shtrihet para nesh.



Gjatë tre viteve të ardhshme i kemi vënë vetes qëllime ambicioze. Ne qëndrojmë të palëkundur në përkushtimin tonë për të mbështetur partnerët tanë në Maqedoninë e Veriut në forcimin e sektorit gjyqësor, krijimin e besueshmërisë në zbatimin e ligjit, përballjen me korrupsionin me vendosmëri të qëndrueshme dhe në mbrojtjen e të drejtave themelore dhe njerëzore të çdo qytetari. Këto nuk janë vetëm objektiva; janë premtime që synojmë t'i përmbushim.

Ndërsa fillojmë këtë udhëtim, nxitemi nga një ndjenjë qëllimi, një vizion për ndryshim pozitiv dhe një përkushtim ndaj suksesit. Vitet në vijim janë plot potencial për transformim dhe përparim dhe ne kemi privilegjin të jemi pjesë e këtij procesi duke punuar për të përforcuar sundimin e ligjit dhe për të fuqizuar popullin e Maqedonisë së Veriut. Projekti ynë nuk është thjesht fillimi; është premtimi i mbështetjes për një të ardhme më të mirë për të gjithë.





Kapim suksesin:

Festë vizuele





Besimi është çelësi: Policia sllovene ndau njohuritë e saj mbi policimin ndërkombëtar dhe mbrojtjen e dëshmitarëve

U zhytëm në një bisedë me **z. Matjaz Jerkic**, Ndhmës Drejtor i Policisë Kriminale në Slloveni për një pasqyrë të rrallë të botës së bashkëpunimit policor ndërkombëtar. Me një përvojë të pasur në shërbimin e hetimit penal, ai kontribuon me përkushtim të fortë në luftën kundër krimit të organizuar dhe mbikëqyr koordinimin qendror të operacioneve brenda Policisë Kriminale Sllovene. Diskutimi ynë u zhvillua pas Trajnimit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve, në bashkëpunim me kolegët e tij maqedonas të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) dhe Prokurorisë, organizuar nga Komponenti 2.

Duke marrë parasysh ndjeshmërinë dhe konfidencialitetin e temave që mbulohen, këto lloj takimesh pune shpesh etiketohen si konfidenciale dhe aty zbulohen informacione të kufizuara. Megjithatë, gjatë diskutimit me z Jerkic, gërvishtëm paksa sipërfaqen e këtyre temave intriguese dhe zbuluam se cili është thelbi i tyre.

“

“Kur përfaqësues nga struktura të ndryshme policore dhe prokuroria e shtetit organizojnë këto lloj takimesh, biseda është e drejtpërdrejtë dhe shumë e hapur. Diskutimet bazohen në përvoja praktike dhe nuk mund të zbulojmë detaje për audiencën më të gjerë. Aty ndajmë përvoja që mund të çojnë në përmirësimin e praktikave dhe mësimin e teknikave të reja në luftën kundër krimit të organizuar. Sipas mendimit tim, biseda e sinqertë është shumë e rëndësishme. Besimi është çelësi”, shpjegoi z. Jerkic.

”

Qëllimi kryesor i trajnimit ishte prezantimi i Programit Slloven për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe diskutimi mbi Programi dhe Njësia për Mbrojtjen e Dëshmitarëve në MPB të Maqedonisë së Veriut dhe se çfarë mund të bëhet për të përmirësuar performancën e tij. Programi i Mbrojtjes së Dëshmitarëve iu prezantua prokurorëve duke përdorur shembuj praktikë nga Sllovenia, për të ofruar një perspektivë të re mbi temën.



“

“Jemi të vetëdijshëm për domethënien e standardeve të unifikuara në luftën kundër krimit të organizuar ndërkombëtar. Zbatimi i tyre është shumë i rëndësishëm në mënyrë që të mos ketë dallime në zbulimin dhe hetimin e krimeve midis shteteve. Andaj, vlerësoj se takimi i sotëm ishte jashtëzakonisht i rëndësishëm sepse paraqitëm përvojat pozitive në zbatimin e programit të mbrojtjes së dëshmitarëve”, përfundoi z. Jerkic.

”

Projekti "Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit" fuqizon mbrojtësit e të drejtave të njeriut duke i trajnuar për parandalimin e diskriminimit dhe promovimin e barazisë

Në tetor, Komponenti 4: Të Drejtat Themelore dhe të Njeriut të projektit "Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit" filloi **trajnimin e programit të trajnerëve "Arti i Trajnimit dhe Lehtësimi me Pjesëmarrje për Parandalimin e Diskriminimit dhe Promovimin e Barazisë"**. Programi përbëhet nga katër module tre-ditore dhe synon stafin e institucioneve kryesore me kompetenca për të drejtat e njeriut - Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi (KPMD), Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS) dhe Zyra e Avokatit të Popullit (ZAP). Atyre u jepet mundësia të fitojnë njohuri dhe aftësi për rritjen e ndërgjegjësimit mbi çështjet e barazisë dhe mosdiskriminimit. **Irina Aceska**, pjesëmarrëse në trajnim dhe përfaqësuese e ZAP, kishte një ndjenjë të fortë se "ndërgjegjësimi i pjesëmarrësve mbi diskriminimin është rritur dhe se ata janë të gatshëm të rrisin ndërgjegjësimin e të tjerëve".

Pjesëmarrësit mbështeten në zhvillimin e aftësive për t'u bërë aleatë të fortë të njerëzve që kanë përjetuar diskriminim dhe për të avokuar për të drejtat e tyre. Aceska, e cila punon për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve të dënuar, tha se pjesëmarrësit "kanë fituar përvojë dhe praktikë se si t'i qasen një grupi që ndihet i diskriminuar, për të cilin më parë nuk kishin qenë të vetëdijshëm se po haste diskriminim".





Programi gjithashtu i pajis pjesëmarrësit e tij një seri metodologjish praktike për të rritur ndërgjegjësimin mbi diskriminimin. Aceska realizon trajnime që synojnë lloje të ndryshme të punonjësve të burgjeve dhe vlerëson përvojat nga metodologjitë: “Trajnoj të gjitha llojet e ndryshme të punonjësve të burgjeve. Disa nga ushtrimet e trajnimit për trajnerë do t'i përshtat në kontekstin tim të punës e disa të tjera do t'i zbatoj në mënyrë direkte. Ushtrimet do të jenë të vlefshme për të përcjellë vlerat të cilave duhet t'u përmbahen punonjësit e burgjeve.”

Metodologjia e trajnimit të trajnerëve ndjek standardet e edukimit për të drejtat e njeriut dhe përqendrohet në një qasje të të mësuarit eksperimental dhe pjesëmarrës, për të siguruar angazhim, përkushtim dhe qëndrueshmëri. Trajnerët Karin Bischof, Biljana Kotevska dhe Dieter Schindlauer aplikuan metoda trajnimi dhe lehtësimi që janë testuar ndërkombëtarisht në terren. “Aftësitë dhe kompetencat e trajnerëve për të ofruar trajnimin në një mënyrë të thjeshtë, të relaksuar dhe njëkohësisht shumë të fokusuar të transmetimit të njohurive” u vlerësuan nga Irina Aceska. Ajo theksoi se do të donte të kishte më shumë trajnime si ky dhe se mezi pret modulet e ardhshme.

REPUBLIC OF SLOVENIA
MINISTRY OF THE INTERIOR



112

**FOR RULE
OF
LAW**

EU SUPPORT

MASSIVA



RULE
OF
LAW



Maqedonia e Veriut avancon reformat në gjyqësor përmes udhëzimeve eksperte dhe bashkëpunimit të palëve të interesuara

INë një bashkëpunim të rëndësishëm, Ministria e Drejtësisë kërkoi ekspertizën e projektit “Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit” për të ofruar mendim rreth planit të Strategjisë Sektoriale Zhvillimore për Sistemin e Drejtësisë 2023-2027.

Një ekip i dedikuar ekspertësh analizoi projekt-dokumentin nga tre këndvështrime kritike: cuke siguruar që ai të përputhet me rregullat dhe standardet nacionale të planifikimit strategjik, duke adresuar sfidat kryesore të identifikuara nga Komisioni Evropian dhe duke krijuar një kuadër efektiv të zbatimit dhe monitorimit.

Ekspertët vunë në dukje fushat kyç për përmirësim të strategjisë. Ata theksuan rëndësinë e kryerjes së një analize gjithëpërfshirëse të situatës për të zbuluar shkaqet themelore të çështjeve dhe propozuan një hierarki të qartë brenda kornizës strategjike, duke theksuar gjithashtu nevojën për një sistem transparent monitorimi.



“

*“Projekti do të mbështesë Ministrinë e Drejtësisë në finalizimin e planit të Strategjisë Sektoriale Zhvillimore për Sistemin e Drejtësisë 2023-2027. Ne besojmë se një Strategji e shëndoshë dhe e mirëhartuar me objektiva të qartë, të realizueshëm dhe të matshëm është shumë e rëndësishme për sigurimin e një gjyqësori të pavarur dhe të paanshëm”, deklaroi **Gocë Kocevski**, ekspert i projektit.*

”



Një moment historik i rëndësishëm u arrit me avancimin e Strategjisë Zhvillimore për Reformat e Gjyqësorit 2023-2027 gjatë një takimi kyç më 19 tetor 2023, të mbajtur në Hotel Holiday Inn Shkup. Anëtarët e grupit të punës përgjegjës për këtë strategji u mbledhën për të diskutuar mbi njohuritë paraprake të ofruara nga grupi i ekspertëve. Një gamë e larmishme aktorësh, duke përfshirë institucionet gjyqësore, organizatat profesionale ligjore dhe grupet e shoqërisë civile, kontribuan në mënyrë aktive me këndvështrimet e tyre.

Gjyqtari Gjorgi Andonov, Kryetar i Gjykatës Themelore në Shtip, që përfaqëson Shoqatën e Gjyqtarëve, theksoi rëndësinë e kësaj strategjie në avancimin e sektorit të drejtësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. “Strategjia ka një rëndësi të veçantë për zhvillimin dhe promovimin e sektorit të drejtësisë, një udhërrëfyes që përcakton qartë qëllimet e arritshme dhe do të jetë një "detyrë shtëpie" për të gjithë aktorët në këtë proces. Kjo është një sfidë se cilës duhet t'i përgjigjemi nëse duam t'i afrohem BE-së”.

Gjatë këtij takimi bashkëpunues, pjesëmarrësit theksuan nevojën urgjente për një strategji praktike dhe të arritshme që trajton drejtpërdrejt sfidat me të cilat përballet gjyqësori i Maqedonisë së Veriut. Diskutime dinamike dhe një vendimmarrje bashkëpunuese karakterizonin gjithë atmosferën.

Kjo përpjekje bashkëpunuese vë në pah fuqinë nga udhëzimi i ekspertëve dhe përpjekjes kolektive në krijimin e një rruge më të mirë për sistemin e drejtësisë të Maqedonisë së Veriut.





Daniella Stefanovska, Këshilltare - Inspektorati Shtetëror i Punës: Rëndësia e trajnimit të vazhdueshëm, bashkëpunimit midis institucioneve dhe komunikimit të qartë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore

Unë jam **Daniella Stefanovska**, Këshilltare - Inspektorati Shtetëror i Punës (ISHP) me ekspertizë në marrëdhëniet e punës. Jam pjesë e Inspektoratit Shtetëror të Punës që nga viti 2010, ndërsa nga viti 2016 jam fokusuar kryesisht në çështjet që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore (TQNJ) për shfrytëzim të punës. Përveç kësaj, unë punoj si trajnere në këtë fushë.



Pas krijimit të një Memorandumi Mirëkuptimi midis Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, ne i kemi modernizuar përpjekjet tona. Tani jam caktuar si pika e kontaktit për ISHP-në për shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin e aktiviteteve, veçanërisht vlerësimet e rrezikut, me Ministrinë e Punëve të Brendshme. Objektivi im kryesor është të rris ndërgjegjësimin midis inspektorëve shtetërorë të punës për ekzistencën e TQNJ për shfrytëzimin e punës. Kjo përfshin njohjen, identifikimin dhe referimin në kohë të viktimave të mundshme, si dhe nxitjen e bashkëpunimit midis të gjithë aktorëve përkatës.

Duke pasur parasysh tendencën rritëse të TQNJ, për mua, si inspektore me përvojë është diçka thelbësore që të jem e përditësuar dhe e informuar mirë.



Praktikat që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore ndryshojnë me kalimin e kohës, të ndikuara nga ndryshimet në shoqëri. Ky evolucion i vazhdueshëm kërkon që ne, si inspektorë, të ecim në hap me kohën dhe të jemi të pajisur për të identifikuar dhe ndihmuar viktimat e mundshme të shfrytëzimit të punës përmes inspektimeve tona. Të diturit se si të bashkëpunojmë në mënyrë efektive me institucionet e tjera përkatëse është diçka jetike për zhvillimin personal dhe profesional dhe të përpjekjeve tona kolektive për të luftuar këtë krim. Të pasurit aftësinë për të udhëzuar inspektorët e tjerë se si të kryejnë inspektime që mund të çojnë në zbulimin e viktimave të mundshme dhe bashkëpunimin e nevojshëm me institucionet e tjera është diçka thelbësore.

Jam jashtëzakonisht mirënjohës për mundësinë për të marrë pjesë në Seminarin për mbledhjen e të dhënave për TQNJ, aktivitet i projektit "Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit", organizuar nga Zyra e Avokatit të Popullit dhe realizuar nga Sasha Jankoviç, ekspert në fushat e Detyrave të Avokatit të Popullit & Mbikëqyrjen e të Drejtave të Njeriut. Seminare si këto janë të dobishme për të na njohur me institucionet e ndryshme dhe personelin e angazhuar për adresimin e TQNJ.



Ndihmon në qartësimin e roleve dhe lehtëson veprimin e shpejtë kur hasim viktimat të mundshme të TQNJ në punën tonë të përditshme. Të mësuarit rreth kuadrit ligjor ndërkombëtar në lidhje me THB, siç është paraqitur me ekspertizë gjatë punëtorisë, thjeshton punën e të gjitha institucioneve, veçanërisht në rastet kur veprime të caktuara nuk mbulojnë në mënyrë eksplicite në legjislacionin shtetëror.



Për sa i përket bashkëpunimit me Raportuesin Nacional për Trafikimin e Qenieve Njerëzore dhe Migracionin e Paligjshëm, është thelbësor krijimi i një kanali të qartë komunikimi midis institucioneve për të shmangur tepricën në mbledhjen e informacionit dhe për të modernizuar mbledhjen e të dhënave. Ky harmonizim do të rrisë efikasitetin e punës së Raportuesit Nacional dhe të institucioneve përkatëse.

Seminari ishte një mundësi e çmuar për t'u njohur me përgjegjësitë e Raportuesit Nacional dhe për të përmirësuar bashkëpunimin. Një koordinim i tillë i përmirësuar, si në nivelin shtetëror ashtu edhe në atë institucional, është thelbësor për arritjen e rezultateve më të rëndësishme në luftën tonë kundër TQNJ.

Në Inspektoratin Shtetëror të Punës, qëllimi ynë është të sigurojmë që asnjë shkelje e ligjit të mos kalojë pa u vënë re nga inspektorët tanë. Ne synojmë të ndërmarrim veprimet e duhura, veçanërisht kur adresojmë shkelje më serioze siç është trafikimi i qenieve njerëzore. Për më tepër, të kuptuarit e roleve dhe përgjegjësive të autoriteteve përkatëse është e rëndësishme për të lehtësuar ndërhyrjet në kohë, për të zënë keqbërësit dhe për të mbrojtur viktimat e mundshme. Që t'i arrijmë këto qëllime, ne vazhdimisht trajnojmë inspektorët tanë dhe zbatojmë procedura rigoroze të inspektimit.





Trajnim i Përbashkët për Komunikim për Institucionet e Pavarura



Në fund të tetorit, njëzet profesionistë nga tre institucione të pavarura u mbledhën në Leunovo për të përmirësuar aftësitë e tyre të komunikimit. **Susanne Hedin**, një Eksperte Suedeze e Komunikimit me përvojë mbi 20 vjeçare punoi me pjesëmarrës nga Avokati i Popullit, KPMD dhe KSHPK për 2,5 ditë duke mbuluar metodat themelore të retorikës dhe ushtrime praktike.

Trajnimi u vlerësua nga pjesëmarrësit si i shkëlqyeshëm, duke u ofruar atyre shumë njohuri dhe këshilla të reja dhe duke vlerësuar trajnimin si "... dukshëm i rëndësishëm për mua dhe kolegët e mi" dhe "... një përvojë e shkëlqyer dhe një shembull i një trajneri profesional i cili mund të mbajë vëmendjen e audiencës dhe nga i cili mund të mësoj shumë". Shumë nga pjesëmarrësit shprehën nevojën dhe dëshirën për të marrë pjesë në trajnime të mëtejshme me ekspertin e njëjtë. Kur u pyetën se çfarë ishte më e dobishme në trajnim, shumë nga pjesëmarrësit përmendën udhëzimet mbi përgatitjen dhe dhënien e informacionit të qartë dhe konciz me pak kohë përgatitjeje.

Aplikimi i kësaj qasjeje të strukturuar në ushtrimet praktike gjatë trajnimit e bëri më të lehtë vazhdimin e përdorimit të kësaj teknike në punën e tyre të përditshme. Për më tepër, fakti që trajnimi mbledhi së bashku profesionistë nga institucione që kanë shumë gjëra të përbashkëta u komentua pozitivisht nga disa persona që vlerësuan se "rrjetëzimi ishte në një nivel shumë të lartë" dhe "ndërveprimi dhe bashkëpunimi me pjesëmarrësit e tjerë ishte i shkëlqyeshëm". Rrjetëzimi që filloi gjatë ditëve në Leunovë do të inkurajohet dhe mbështetet përmes aktiviteteve pas pune për anti-korrupsion të Komponentit. Gjithashtu, janë planifikuar trajnime vijuese për Komunikimin e Jashtëm dhe të Brendshëm dhe Tregim të historive me po këto institucione.

Drejt një Plani Nacional Gjithpërfshirës të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve në Maqedoninë e Veriut

Aktualisht, ka disa plane të ndryshme veprimi në fuqi që mbulojnë të drejtat e fëmijëve në segmente të ndryshme.

“

Megjithatë, Maqedonisë së Veriut i mungon një plan nacional veprimi i cili sjell në fokus promovimin e të drejtave të fëmijëve në një dokument të vetëm, siç analizoi **Elka Todorova**, Shefe e Departamentit për Familjen Sociale dhe Mbrojtjen Ligjore të Fëmijëve dhe Familjes në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale.

”

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale me mbështetjen e ekspertëve **Keti Jandrijeska Jovanova**, **Karin Bischof** dhe **Helmut Sax** krijuan një grup pune, i cili përfshin të gjitha institucionet dhe organizatat përkatëse për zhvillimin e një Plani Nacional të Veprimit (PNV) për të Drejtat e Fëmijëve. Grupi i punës përbëhet nga përfaqësues të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Financave, Entit Shtetëror të Statistikave, Avokatit të Popullit, Entit për Veprimtari Sociale, Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, UNICEF-it dhe përfaqësues të OJQ-ve. Sipas Lidija Shterjov, Shefe e Departamentit për Përfshirje Sociale në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, përbërja e grupit të punës garanton "një qasje multidisiplinare", si dhe përfshirjen e "të gjithë faktorëve përkatës dhe burimeve në dispozicion nga sektorët qeveritarë dhe joqeveritarë" për të marrë masa që synojnë "përmirësimin e pozitës së përgjithshme të fëmijëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut".

Anëtarët e grupit të punës ndajnë përvojat e tyre dhe identifikojnë sfidat në realizimin e të drejtave të fëmijëve nëpërmes një serie takimesh.

Vesna Mitrevska, anëtare e grupit të punës dhe këshilltare shtetërore për çështje të përgjithshme dhe organizative në Sekretariatit e Përgjithshëm të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, vlerësoi "qartësinë e procesit përmes të cilit krijohet Plani Nacional i Veprimit".

Moderatorët krijuan një "koncept konciz me një qëllim të qartë" dhe ofruan "materiale koncize dhe të qarta" për zhvillimin e planit. Asaj "i pëlqeu shumë pritja e pjesëmarrësve nga moderatorët, përfshirja e tyre e ndërsjellë dhe energjia e mirë".

Moderatorët/ekspertët, Ketii Jandrijeska Jovanova, Karin Bischof dhe Helmut Sax sigurojnë një mënyrë pjesëmarrëse të zhvillimit të planit të veprimit. Lidija Shterjov vlerësoi shumë "metodën pjesëmarrëse të punës, e cila kontribuon në shkëmbimin e përvojave nga të gjitha institucionet e ndryshme dhe mbledhjen e sfidave të shumta". Kjo metodë gjithashtu lejon përkushtimin dhe kontributin e secilit duke lehtësuar zbatimin e planit. Vesna Mitrevska është e bindur se "qasja pjesëmarrëse dhe pjesëmarrja aktive e moderatorëve/ekspertëve dhe pjesëmarrësve do të kontribuojnë në krijimin e një PNV cilësor për të drejtat e fëmijëve që – kur të zbatohet – mund të përmirësojë në mënyrë të theksuar të drejtat e fëmijëve në Maqedoninë e Veriut".

Çështjet e identifikuara si më të nxitueshme nga GP në zhvillimin e PNV për të Drejtat e Fëmijëve:

1. Keqtrajtimi dhe dhuna ndaj fëmijëve
2. Incidentet e bullizmit në shkolla
3. Fëmijët që përballen me kushte banimi nën standarde
4. Ndikimi i sfidave mjedisore tek fëmijët
5. Shkalla e pamjaftueshme e pjesëmarrjes së fëmijëve në arsimin e hershëm dhe fillor
6. Fëmijët në institucionet korrektuese arsimore nuk kanë qasje në arsim
7. Qasje e kufizuar në shërbime adekuate të kujdesit shëndetësor për fëmijët
8. Mbështetje e pamjaftueshme për fëmijët që merren me abuzimin e drogave dhe substancave
9. Asistencë e pamjaftueshme për fëmijët që përballen me sfida të shëndetit mendor




Deri më tani janë zhvilluar dy takime të grupeve të punës, të cilat kanë rezultuar në identifikimin e sfidave kryesore gjatë realizimit të të drejtave të fëmijëve, si dhe në zhvillimin e qëllimeve dhe masave. Elka Todorova nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale është optimiste se takimet e grupeve të punës do të kontribuojnë në “miratimin e një Plani gjithpërfshirës Nacional të Veprimit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, i cili synon të forcojë rolin e fëmijëve dhe t’u japë përparësi absolute të drejtave dhe interesave të tyre”. Hapi tjetër është organizimi i një Paneli të Fëmijëve për të integruar perspektivën e fëmijëve dhe të rinjve me prejardhje të ndryshme në planin e veprimit. Vesna Mitrevska e vlerësoi si pozitiv propozimin e ekspertëve “për t’u konsultuar me fëmijët që do të ndikohen drejtpërdrejt nga zbatimi i planit të veprimit”.






REPUBLIC OF SLOVENIA
MINISTRY OF THE INTERIOR



EU SUPPORT FOR **RULE
OF
LAW**



Forcimi i ndërgjegjësimit dhe komunikimit në shërbimin e probacionit

Duhet të rritet dhe forcohet ndërgjegjësimi rreth përfitimeve nga sanksionet alternative. Sanksionet alternative kontribuojnë në rehabilitimin dhe riintegrimin e personave të dënuar, zvogëlojnë recidivizmin dhe rrisin sigurinë e bashkësisë. Duke mbështetur krijimin e një grupi pune për marrëdhënie me publikun me oficerë të shërbimit të probacionit, projekti mbështet Drejtorinë për Ekzekutimin e Sanksioneve në Ministrinë e Drejtësisë në forcimin e masave të tyre të ndërgjegjësimit.

Trajnimi i parë me grupin e punës për marrëdhëniet me publikun synoi rritjen e aftësive të komunikimit të oficerëve të shërbimit të probacionit duke i pajisur ata me metoda praktike për komunikim të suksesshëm. Trajnerja, **Meri Bakallova**, prezantoi metoda dhe mjete në mënyrë shkallë-shkallë, duke i lejuar pjesëmarrësit të testojnë dhe zbatojnë njohuritë e tyre të reja në mënyrë bashkëpunuese në grupe më të vogla. Trajnerja siguroi hapësirë për forcimin e besimit të pjesëmarrësve kur kanë të bëjnë me mediat përmes ofrimit të teknikave për marrëdhënie efektive me mediat dhe krijim të produkteve mediatike. Pjesëmarrësit përshkruan teknikat që kishin mundësinë të zbatonin përmes ushtrimeve për "dhënien e intervistave", "shkrimin e një njoftimi për shtyp" dhe "zhvillimin e një plani mediatik".





Pjesëmarrësit e cilësuan atmosferën e krijuar nga trajneri si mbështetëse, duke "i bërë ata të ndihen rehat dhe duke i inkurajuar që të marrin pjesë aktivisht në diskutime dhe aktivitete". "Vetë ambienti i trajnimit" si dhe "udhëzimi i ekspertëve" kontribuan edhe më tej për një "atmosferë pozitive".

Pas trajnimit, pjesëmarrësit ishin të gatshëm të zbatonin aftësitë dhe njohuritë e tyre në rolet e tyre përkatëse si oficerë të probacionit. Aftësitë e forcuara nga trajnimi do të rrisin efektivitetin e përpjekjeve të tyre të komunikimit dhe do të kontribuojnë në rritjen e ndërgjegjësimit për përfitimet e sanksioneve alternative dhe mund të kontribuojnë në rritjen e numrit të rasteve për të cilat vendosen masa alternative.



Ndikimi afatgjatë i këtij trajnimi shtrihet përtej rezultateve të menjëhershme. Duke forcuar aftësitë e oficerëve të shërbimit të probacionit për marrëdhënieve me mediat dhe duke ushqyer aftësinë e tyre për të krijuar produkte thelbësore mediatike, përfshirë njoftime për shtyp, konferenca për media, intervista, konferenca për shtyp dhe materiale të tjera komunikimi, ne i fuqizojmë ata të kenë përpjekjet efektive të komunikimit. Kjo mundëson avokim të vazhdueshëm për sanksione alternative dhe rehabilitimin e individëve të dënuar. Si rezultat, ata mund të bashkëveprojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe profesionale me mediat, duke mirëmbajtur një mbështetje dhe ndërgjegjësim të qëndrueshëm të bashkësisë dhe duke rritur përdorimin e masave alternative me kalimin e kohës.



Trajnimi gjithashtu theksoi rëndësinë e një Strategjie të mirëstrukturuar të Komunikimit dhe Vizibilitetit. Ekspertja Meri Bakallova kishte filluar zhvillimin e një strategjie të tillë para trajnimit dhe me këtë rast mori të dhëna për zhvillimin e mëtejshëm të strategjisë. Një strategji e tillë mbështet krijimin e strategjive gjithëpërfshirëse të mesazheve, hartimin e aktiviteteve të komunikimit, identifikimin e kanaleve optimale të komunikimit dhe zbatimin e mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit.

Projekti do të vazhdojë të mbështesë grupin e punës për marrëdhëniet me publikun të oficerëve të shërbimit të probacionit duke ofruar aktivitete të mëtejshme trajnimi. Pjesëmarrësit shprehën interes të madh për të ndjekur trajnime të tjera për fusha të ngjashme në të ardhmen. Për më tepër, ekspertja Meri Bakallova do të vazhdojë së krijuari një mjedis për rritjen e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave në mesin e grupit të oficerëve të shërbimit të probacionit gjatë zbatimit të Strategjisë së Komunikimit dhe Vizibilitetit.



KALENDARI I NGJARJEVE TË RADHËS

27
NËNTOR

29
DHJETOR

Tavolinë e rrumbullakët
Gjykatësit e Maqedonia e Veriut
dhe anëtarët e Këshillit Gjyqësor
Komponenti 1

07
NËNTOR

09
NËNTOR

Vizitë studimore në Slloveni
Përfqësues nga Departamenti i
Mbështetjes dhe Dokumentimit
Komponenti 2

13
NËNTOR

17
NËNTOR

**Trajnim mbi inteligjencën
njerëzore**
Komponenti 2

14
DHJETOR

20
SEP

**Trajnim i brendshëm për
komunikim për
institucionet e pavarura**
Komponenti 3 + komponenti 4

16
NËNTOR

**Paneli Fëmijët për të
Drejtat e Fëmijëve**
Europe House Skopje
Komponenti 4

12
DHJETOR

**Konferenca
Ndërkombëtare në 25
vjetorin e institucionit të
Avokatit të Popullit**
Skopje
Komponenti 4



Kapim suksesin:

Festë vizuele

